

University of Business and Technology in Kosovo

UBT Knowledge Center

Theses and Dissertations

Student Work

Spring 3-2017

**ROLI DHE NDIKIMI I POLITIKAVE FISKALE – ME THEKS NË
NDRYSHIMET E FUNDIT**

Edona Kullashi

Follow this and additional works at: <https://knowledgecenter.ubt-uni.net/etd>



Part of the [Business Commons](#)



Koleji UBT
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

**RËNDËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR PËRFITIM TË
BIZNESEVE**
Shkalla Bachelor

Eda Gorda

Maj / 2017
Prishtinë



Kolegji UBT
Fakulteti për Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi

Punim Diplome
Viti akademik 2012-2013

Eda Gorda

**RËNDËSIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM PËR PËRFITIM TË
BIZNESEVE**

Mentor: Dr. Sc. Bukurie Jusufi

Maj / 2017

Ky punim është përpiluar dhe dorëzuar në përmbushjen e kërkesave të
pjeshme për Shkallën Bachelor

ABSTRAKT

Auditimi luan rol të rëndësishëm për çdo biznes i cili dëshiron të rris transparencën, besueshmërinë dhe rregullsinë, prandaj kjo është njëra nga arsyet e përzgjedhjes së temës së diplomës. Edhe pse Kosova është shtet i ri dhe në tranzicion me kushtet të cilat ishin të vështira në fillim, shteti ynë në bashkëpunim me vendet mike, ka filluar të bëj hapa të sigurt në aspektin e raportimit dhe kontrollit financiar.

Zhvillimet e vazhdueshme dhe komplekse ekonomike të ditëve të sotme janë shoqëruar me procese e sisteme "të sofistikuar" financiare, që krahas rritjes së shpejtësisë të veprimeve financiare, në shumë raste janë stimuluar dhe fenomene abuzive deri në skandale të përmasave të mëdha, në përdorimin e fondeve publike dhe private, por jo vetëm, në institucione, tregje, kompani e korporata. Për këtë arsye vihet në pah edhe nevoja për më shumë vëmendje, kontroll e mbikëqyrje. Kjo ka shtyrë që kompani, korporata e institucione tjera t'i japin hapsirë dhe rol mjaft të rëndësishëm auditimit.

Në këtë punim është përshkruar evoluimi i auditimit, definimi i auditimit, me një fokus të veçantë në auditimin e brendshëm, llojet e auditimit të brendshëm, roli i auditorit të brendshëm, fazat gjatë procesit të auditimit të brendshëm, dhe parimet e funksionit të auditimit të brendshëm.

Rezultatet që dalin pas një procesi të auditimit janë një vlerë e shtuar për veprimtarinë e ndërrmarjeve. Por kjo nuk do të thotë që kjo vlerë e shtuar është sinjal direkt i përmirësimit ekonomik të asaj ndërrmarje por vlera që sjell në përmirësimin e shërbimeve ndaj publikut është dukshëm më pozitive, pastaj ndërrmarja ndihmohet në përcaktimin e problemeve, dhe mbi këtë bazë, rezultatet e auditimit, i ndihmojnë bordet/organet vendimmarrëse të marrin masat e duhura në mënyrë që të kalojnë sa më lehtë problemet e paraqitura dhe të parandalojnë sa më shumë nga problemet që mund të shfaqen në të ardhmen.

MIRËNJOHJE DHE FALENDËRIME

Unë do të doja të fillojë tezën time me falendërimin për të gjithë ata që më ndihmuan dhe më dhanë kurajë të realizojë Punimin e Diplomës së Bachelor-it në drejtimin Menaxhment, Biznes dhe Ekonomi.

Jam mirënjohëse dhe sinqerisht e falendëroj mentoren e temës Prof. Dr. Bukurie Jusufi, pa të cilën ky studim nuk do të ishte i mundur. Me ndikim pozitiv të integritit të udhëzimeve, mirëkuptimit, durimit, këshillave, metodave, ideve dhe motivimit nga mentori, arrita në përfundim të suksesshëm të punimit. Mbikëqyrja e temës nga ana e saj, më ofroi mundësi dhe më pasuroi me një gamë të gjërë të informacioneve, ky kontribut do të jetë udhërrëfyese në karrierën time profesionale.

Do të doja të shpreh falendërimet më të sinqerta për mbështetjen dhe përkrahjen e tyre prindërit e mi, shoqërinë time dhe kolegët e UBT – së.

Gjithshtu, e falendëroj menaxhmentin e organizatave që më lejuan dhe më ndihmuan të aplikoj pjesën hulumtuese të studimit.

Eda Gorda
Prill, 2017
Prishtinë

PËRMBAJTJA

FJALORI I TERMAVE	IV
1. HYRJE.....	1
2. SHQYRTIMI I LITERATURËS.....	3
2.1 Evoluimi i Auditimit	3
2.2 Definimi i Auditimit	5
2.3 Auditimi i brendshëm	6
2.4 Llojet e auditimit të brendshëm	9
2.5 Roli i auditorit të brendshëm	11
2.5.1 Përgjegjësia për mashtime dhe gabime	14
2.5.2 Kufizimet në funksionin e Auditit të brendshëm	14
2.6 Rregullativat e Auditimit të Brendshëm në Kosovë	15
2.7 Parimet e Përgjithshme të Funksionimit të Auditimit të Brendshëm	15
2.8 Hapat gjatë procesit të auditimit të brendshëm.....	16
2.8.1 Planifikimi	16
2.8.2 Puna në terren	18
2.8.3 Periudha Raportuese	19
2.8.4 Periudha Rivlerësuese.....	20
3. DEKLARIMI I PROBLEMIT	21
4. METODOLOGJIA	22
5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE.....	23
6. KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	28
7. REFERENCAT	29
8. APPENDIXES	31

FJALORI I TERMAVE

ACCA - Association of Chartered Certified Accountants

IIA - Institute of Internal Auditors

IPPF - International Professional Practices Framework

ISA - International Standards on Auditing

KB - Kontrolli i brendshëm

1. HYRJE

Nevoja e njerëzve për shqyrtimin e hollësishëm të veprimtarive të tyre ekonomike daton qysh në kohët e lashta. Administrimi sa më transparent i pasurisë lindi nevojën e shërbimeve menaxhuese si kontabiliteti dhe auditimi.

Auditimi është proces i sistematizuar i mbledhjes dhe krijimit të argumenteve mbi veprimtarinë ekonomike dhe rezultatit me qëllim që të konstatohet baraspesha në mes të raporteve të afarizmit dhe kritereve të parashtruara dhe kjo t'iu dërgohet shfrytëzuesve të interesuar.

Meqenëse niveli më i lartë i menaxhimit në organizatë ka përgjegjësinë kryesore për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, realizimin e objektivave dhe miratimin e treguesve ekonomiko-financiar, pra të llogaridhënies vjetore, ai ka nevojë për një siguri objektive lidhur me funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm me qëllim që të sigurojë realizimin e objektivave nga njëra anë dhe mirëadministrimin e përdorimit të fondeve nga ana tjetër. Kjo nevojë apo kërkesë e nivelit të lartë të menaxhimit, vjen natyrshëm sepse në momentin e llogaridhënies ai paraqitet njëkohësisht edhe si “pronar” për organizatën që drejton, por edhe si llogaridhënës për “pronarin e vërtetë” të cilit i shërben (në sektorin privat për aksionarët dhe në sektorin publik për përfaqësuesin e “pronës shtet”, Institucioni i pavarur, Ministria, Kryeministria apo Parlamenti).

Auditimi përqendrohet më së shumti në aftësi analitike dhe logjike të domosdoshme për të vlerësuar rëndësinë dhe besueshmërinë e sistemeve dhe proceseve përgjegjëse për regjistrimin dhe përmbledhjen e informacionit financiar, por dhe informacionit në përgjithësi. Auditimi ndihmon dhe siguron që informacioni të jetë i besueshëm, i verifikueshëm, i rëndësishëm dhe i raportuar në kohë. Si një fushë dinamike për përkrahjen e organizatave në arritjen e objektivave të tyre, Auditimi i Brendshëm merret me vlerësimin dhe përmirësimin e efektivitetit të proceseve të menaxhimit të riskut, kontrollit dhe qeverisjes në një organizatë. Qëllimi i realizimit të këtij punimi është ofrimi i njohurive mbi funksionin e auditimit të brendshëm, dhe punës së tij në kuadër të ambienteve afariste dhe financiare. Objektivi

kryesore e hulumtimit për arritjen e këtij qëllimi është analizimi teorik përmes shqyrtimit të literaturës, si dhe analizimi praktik i auditimit të brendshëm, duke marrë si rast studimi kompanitë që veprojnë në sektorin privat në Kosovë, dhe përfitimet që ato kanë nga auditimi i brendshëm i kompanive të tyre.

Nga pikëpamja akademike, ky punim do të shërbejë për një studim më të thelluar të evoluimit, përkufizimit, konceptimit dhe trajtimit të auditimit të brendshëm e që kjo mënyrë do të jetë shumë e vlefshme për kërkues e studiues të tjerë në vazhdimësi.

Metodologjia e përdorur për realizimin e këtij hulumtimi përfshin:

1. Analizën e literaturës historike, shkencore, bashkëkohore për auditimin e brendshëm, që përdoret sot më gjerësisht në botë.
3. Pyetësor me drejtues divizionesh, departamentesh dhe degësh e profesionistë të entiteteve të auditura në lidhje me faktorët e suksesit dhe treguesit e efektivitetit të Auditimit të brendshëm.
4. Studimi i legjislacionit ekzistues të auditimit dhe institucioneve të tij në eksperiencën Kosovare.
5. Integrimi i informacioneve dhe nxjerrja e rezultateve përfundimtare.

2. SHQYRTIMI I LITERATURËS

2.1 Evoluimi i Auditimit

Fjala auditim rrjedh prej fjalës latine “audire” që do të thotë dëgjim, pra të dëgjosh. Auditimi është zhvilluar në vendet anglishtë folëse sepse aty kishte një zhvillim të lartë ekonomik. Tregjet e para të shënuara të auditimit në Britaninë e Madhe datojnë në vitin 1130, koncepti auditues zyrtarish paraqitet në vitin 1285 në një drekë të Eduardit të Parë. Referimet e para të termit auditim (Ang. auditing) gjenden në Angli që nga viti 1300, atëherë kur u krijua figura e “Auditorit të Shtetit”, zyrtarët publik i ngarkuan për të kontrolluar shpenzimet publike. Auditimi modern ka filluar të zhvillohet në vitin 1939 në SHBA përmes Institutit të Kontabiliteteve Publik të Autorizuar (AICPA) që dha raportin e parë mbi veprimtarinë e auditimit (*Jakupi & Krasniqi, 2012*).

Kuptimin e nocionit “Auditim”, auditorët dhe institucionet e definojnë në mënyra të ndryshme, ku mund të caktohen një varg definicionesh si më poshtë:

Auditimi është proces i sistematizuar i mbledhjes dhe krijimit të argumenteve mbi veprimtarinë ekonomike dhe rezultatit me qëllim që të konstatohet baraspesha në mes të raporteve të afarizmit dhe kritereve të parashtruara dhe kjo t’u dërgohet shfrytëzuesve të interesuar.

Në përgjithësi, zhvillimi i hershëm historik i auditimit nuk është i dokumentuar mirë. Auditimi në formën e aktiviteteve të lashta kontrolluese u gjet në bazën e civilizimeve të vjetra të Kinës, Egjipt dhe Greqi. Disa prej formave të auditimit dhe kontabilitetit i gjejmë rreth 350 vjet para Krishtit, në Greqinë e lashtë, ndërsa vetëm në 200 vitet e fundit kërkesa për rritjen dhe zbatimin e shërbimit të auditimit ka pësuar një rritje shumë të shpejtë (*Lee & Azham, 2008*).

Sipas Porter (2005) auditimi kishte pak aplikim komercial para revolucionit industrial. Kjo për shkak se industritë gjatë kësaj periudhe ishin kryesisht me shtëpi dhe mullinj të vogël të cilat ishin në pronësi individuale dhe të menaxhuara nga vet pronarët. Për këtë arsye, nuk ka pasur nevojë për menaxherët e biznesit t’u raportojnë pronarëve për menaxhimin e burimeve

të tyre. Si rezultat i kësaj, gjatë kësaj periudhe auditimi nuk kishte aplikim. Në pak fjalë, gjatë periudhës së para vitit 1840, auditimi ishte i kufizuar në kryerjen e verifikimit të detajuar të çdo transaksioni.

Praktikat e auditimit nuk u bënë të qëndrueshme deri në ardhjen e revolucionit industrial në periudhën 1840-1920 në Mbretërinë e Bashkuar. Kjo do të thotë që auditimi ka evoluar e u rrit me shpejtësi pas revolucionit industrial në shekullin e XVIII.

Në shekullin XVIII-XIX shumica e njësive ishin të organizuara si vetë-pronësi dhe bashkëpronësi. Gjatë revolucionit industrial, nevoja e kompanive për rritje dhe zhvillim në tregje ndërkombëtare, për financim projektsh të kushtueshme si dhe e inovacioneve të ndryshme kërkonte rritje të financimit të kapitalit dhe rrjedhimisht rritje të tregjeve të kapitalit ku mund të shiteshin e të bliheshin lirisht copa pronësie (aksione) duke krijuar në mënyrë të tillë korporatat (*Ramamoorti, 2003*).

Pra, tipari i transferimit të pronësisë si dhe specializimi i njësive krijoi fenomenin e mungesës së pronarëve dhe zëvendësimin e interesave të tyre nëpërmjet përfaqësimit nga menaxherët ose drejtuesit. Kontabiliteti dhe auditimi luajtën një rol të rëndësishëm në marrëdhënien mes pronarëve dhe menaxherëve. Auditimi është një proces sistematik i marrjes dhe vlerësimit objektiv të evidencës lidhur me deklaratimet mbi veprimet dhe ngjarjet ekonomike për të përcaktuar nivelin e korrespondencës mes këtyre deklaratimeve dhe kritereve të vendosura dhe në fund komunikimit të rezultateve të përdoruesve të interesuar (*Ramamoorti, 2003*).

Gjatë revolucionit industrial u shfaq një "klasë e mesme" e shoqërisë e cila balançoi të ardhurat midis klasës së pasur dhe asaj të varfër me ç'rast u bë e mundur që të sigurohen fondet për krijimin e ndërmarrjeve të mëdha industriale dhe tregtare. Revolucionit industrial rezultoi në formimin e ndërmarrjeve të mëdha, korporatave, fabrikave dhe ndarja e funksioneve të pronësisë dhe menaxhimit u bënë më të dukshme. Për këtë arsye në funksion të këtij mjedisi, për të siguruar se fondet në mënyrë të vazhdueshme në tregjet financiare të funksionojnë normalisht dhe për të siguruar apo për të bindur pjesëmarrësit në tregjet financiare se deklaratat financiare të kompanisë janë të vërteta dhe të besueshme ishte në nevojë urgjente për Auditorët. Pra, koha ishte që profesioni e auditimit të shfaqet dhe të zhvillohej (*Porter, Simon & Hatherly, 2005*).

Edhe pse qëllimi fillestar i auditimit ishte për të zbuluar dhe për të parandaluar gabimet dhe mashtrimet. Objektivat e auditimit veqse kishin pësuar ndryshime pasi auditimi tashmë përdorej që të konstatojë nëse llogaritë ishin të vërteta dhe të drejta më tepër se zbulimi i gabimeve dhe mashtrimeve (*Porter, Simon & Hatherly, 2005*).

2.2 Definimi i Auditimit

Auditimi është një aktivitet i pavarur, konsultues, konfirmues, objektiv, i përcaktuar për të shtuar vlerë dhe për të përmirësuar veprimtarinë e organizatave. Auditimi i ndihmon një organizatë të arrijë objektivat e vëna duke ndjekur në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e legjislacionit, duke e vlerësuar aktivitetin dhe synuar përmirësimin e tij, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe të menaxhimit të rreziqeve. Auditimit ka të bëjë me verifikimin e të dhënave të kontabilitetit, dhe paraqitjen e saktësisë dhe besueshmërisë të regjistrave kontabël (*Mautz, 1954*), ai është një ekzaminim sistematik i librave dhe regjistrimeve të një biznesi e që shërben për të konstatuar (verifikuar) dhe për të raportuar, në bazë të fakteve në lidhje me punën financiare (*Montgomery, 1949*).

Auditimet klasifikohen në katër kategori kryesore:

1. Auditimet financiare,
2. Auditimet e përputhshmërisë,
3. Auditimet e operacioneve dhe
4. Auditimet e integruara.

Auditimi financiar paraqet auditimin e informatave të kontabilitetit financiar të një entiteti. Ndryshe quhet si auditimi i pasqyrave financiare dhe zakonisht përfshinë bilancin e gjendjes, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e fitimeve të mbajtura, dhe rrjedhën e parasë. Dhe më gjerësisht auditimi i pasqyrave financiare i cili konsiderohet edhe si lloji më i rëndësishëm i auditimit do të shtjellohet më poshtë.

Auditimi i përputhshmërisë është i varur nga ekzistimi i të dhënave të verifikueshme dhe ekzistimi i kritereve ose standardeve të pranueshme, siç janë ligjet dhe rregulloret, ose politikat dhe procedurat e organizatës. Do të thotë këto auditime janë të dizajnuara për të

përcaktuar nëse asistenca financiare është shpenzuar në përputhje me ligjet dhe rregulloret e aplikueshme.

Auditimi i operacioneve paraqet studimin e një njësie specifike të organizatës me qëllim të matjes së performancës së saj.

Auditime të integruara përfshijnë dhënien e sigurisë për pasqyrat financiare si dhe efektivitetin e kontroleve të brendshme mbi raportimin financiar (*Porter, Simon & Hatherly, 2005*).

Në bazë të shtrirjes, auditimi klasifikohet në:

- Auditimin e përgjithshëm, që shtrihen në të gjithë menaxhimin, për një periudhë të dhënë,
- Auditimin e veçant, kur është një objektiv, një çështje ose një sektor.

Në bazë të qëllimit, auditimi klasifikohet në:

- Auditimet parandaluese, që kryhen në momentin që ndodh veprimi ekonomik
- Auditimet përfundimtare, që kryhen më pas dhe synojnë në zbulimin e gabimeve, mangësive dhe anomalive.

Në bazë të personit që kontrollon, auditimi klasifikohet në:

- Auditimet e brendshme, që organizohet nga vetë njësia ekonomike,
- Auditimet e jashtme, që kryhen nga auditorë profesionistë (*Porter, Simon & Hatherly, 2005*).

2.3 Auditimi i brendshëm

Auditimi i brendshëm ka evoluar si rezultat i nevojave të organizatave biznesore, joqeveritare dhe qeveritare. Fillimisht, kërkesa për auditim të brendshëm ka lindur kur menaxherët e korporatave të mëdha kuptuan se auditimet vjetore të pasqyrave financiare nuk janë të mjaftueshme. Ekzistonte nevoja për përfshirjen e punonjësve të brendshëm përtej nivelit të përfshirjes së auditorëve të jashtëm për të mundësuar shënime financiare të sakta dhe në kohë të duhur si dhe për të parandaluar mashtrimet. Këta auditorë të brendshëm i përqendruan përpjekjet e tyre në çështjet financiare dhe kontabël (*Ministria e Financave, 2011*).

Auditimi i brendshëm së bashku me auditimin e pasqyrave financiare është segment shumë i rëndësishëm i auditimit si profesion në përgjithësi. Auditimi i brendshëm është projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës. Kjo ndihmon organizatën në përmbushjen e objektivave të saj duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të riskut, kontrollit dhe proceseve (IPPF, 2011). Mendimi i përgjithshëm i auditimit të brendshëm duhet të orientohet në nënvizimin dhe harmonizimin e rregullave bazë të kontroll-revizionit me rregullat dhe konceptet që janë formuar në kuadrin e drejtimit të njësisë ekonomike konkrete. Qëllimi kryesor i auditorit të brendshëm është të hetoj dhe vlerësojë efektivitetin me të cilin njësitë e ndryshme të kompanisë janë duke i kryer detyrat e tyre të caktuara (IIA, 2006).

Auditimi i brendshëm është një funksion i themeluar nga menaxhmenti për të ndihmuar në qeverisjen e korporatave duke vlerësuar kontrollet e brendshme dhe duke ndihmuar në menaxhimin e riskut. Ajo mund të jetë një departament i të punësuarve ose mund t'ju jepet ekspertëve që ofrojnë shërbimeve të auditimit (IIA, 2006).

Auditimi i brendshëm është një vlerësim ose monitorimi i aktiviteteve të themeluara brenda një entiteti si një shërbim për vetë entitetin. I ndihmon një organizate t'i përmbush objektivat e saj duke sjell një qasje sistematike, të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektshmërinë e:

- Kontrollit financiar dhe operacional.
- Menaxhimit të rrezikut.
- Qeverisjes (IIA, 2006).

Punët më të rëndësishme që i kryen auditori i brendshëm në kuadër të ndërmarrjes janë: hetimi i funksionimit të sistemit kontabël, hetimi i të dhënave të tjera dhe kontabël, hetimi i efikasitetit, ekonomitetit dhe efektivitetit në funksionimin e ndërmarrjes. Auditimin e brendshëm e zbatojnë personat e punësuar në ndërmarrje të cilët e organizojnë dhe e zbatojnë programin e auditimit të brendshëm. Auditorët e brendshëm zakonisht i raportojnë komitetit të auditimit të bordit të drejtorëve dhe gjithashtu presidentit ose ndonjë personi me nivel të

lantë ekzekutiv. Auditorët e brendshëm gjerësisht punësohen edhe nga organizatat qeveritare dhe jo-fitimprurëse. Është thelbësore që auditorët e brendshëm të jenë të pavarur nga drejtorët e departamenteve dhe personat e tjerë ekzekutiv punën e të cilëve ata e rishikojnë. Kështu që, nuk do të ishte e dëshirueshme që auditorët e brendshëm të jenë nën përgjegjësi të udhëheqësit të kontabilitetit. Pavarësisht nga niveli i raportimit të tyre, prapë se prapë, auditorët e brendshëm nuk janë të pavarur në kuptim të njëjtë sikurse auditorët e jashtëm. Auditorët e brendshëm janë punëtorë të përhershëm në kompani, dhe janë subjekt i kufizimeve që rrjedhin si rezultat i marrëdhënies punëtor-punëdhënës. Sa më shumë transformohen marrëdhëniet profesionale në marrëdhënie shoqërore, aq më shumë rritet rreziku i mungesës së drejtësisë dhe i aktivitetit të kontrollit (IIA, 2006).

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i cili është dizajnuar për t'i shtuar vlerat dhe për t'i përmirësuar veprimtaritë e organizatës. Audituesit e Brendshëm mbulojnë një gamë të gjerë sistemesh/fushash, përveç veprimtarive të financës dhe shikojnë sisteme si: menaxhimi i riskut, kontrolli i buxhetit dhe planifikimi financiar afatmesëm e të tjerë.

Procesi i auditimit të brendshëm kalon nëpër katër faza:

- Planifikimi dhe krijimi i qasjes revizore, në këtë fazë firma revizionuese duhet të bëjë selektimin e klientëve për të sjellur vendimet për angazhim ose refuzim të tyre, dhe zëvendësim me të tjerë.
- Realizimi i testeve të kontrollit dhe testimi bazik i transaksioneve, në këtë fazë revizorët duhet të saktësojnë shkallën e sigurisë së të dhënave financiare që janë në mënyrë të drejtëpërdrejt të lidhura me argumentet revizore.
- Realizimi i procedurave analitike të saldove të veçanta të kontove, në këtë fazë bëhen teste dhe procedura analitike të saldove të veçanta
- Kompletimi i revizionit dhe publikimi i raporteve revizore, në këtë fazë bëhet kombinimi i të dhënave për të formuar mendimin revizionues.

Procesi i auditimit kalon nëpër disa faza për t'u përfunduar: njoftimi, planifikimi, mbledhja e hapjes, puna në terren, komunikimi, hartimi i raportit, përgjigjia apo reagimi i menaxhmentit, mbledhja mbyllëse, krijimi i raportit final dhe distribuimi i tij dhe rishikimi.

Rëndësia kyçe e kësaj faze është se pas marrjes së dokumentave të kërkuara auditorit i mundësohet krijimi i një liste të punës (check list) (IIA, 2006).

2.4 Llojet e auditimit të brendshëm

Auditimi i brendshëm përfshinë:

- a) Shërbimet e sigurisë dhe shërbimet e konsulencës.
- b) Auditimi mbi bazë sistemi.
- c) Auditimi i përputhshmërisë.
- d) Auditimi i performancës.
- e) Auditimet financiare.
- f) Auditimet e Teknologjisë së Informacionit (TI).
- g) Angazhimet e auditimit për këshillim.
- h) Angazhimet e auditimit për shërbim konsulence.

Shërbimet e sigurisë dhe shërbimet e konsulencës. Një angazhim auditimi për shërbimet e sigurisë zhvillohet në një auditim me bazë sistemi nëpërmjet auditimit të përputhshmërisë, auditimit të performancës, auditimit financiar, auditimit të teknologjisë së informacionit apo nëpërmjet kombinimit të llojeve të ndryshme të auditimit. Një angazhim auditimi për shërbimin e konsulencës përfshin veprimtari këshilluese dhe të tjera si: konsulta, këshilla, ndihmë dhe trajnime, natyra dhe objekti i të cilave miratohen nga kreu i organizatës (Ministria e Financave të Shqipërisë, 2010).

Auditimi mbi bazë sistemi. Auditimi i sistemeve përfaqëson një vlerësim në thellësi të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm të vendosura nga niveli i menaxhimit, me qëllim që të përcaktojë nëse ato po funksionojnë me kosto efektive, në mënyrë eficiente dhe për arritjen e objektivave, dhe që janë në gjendje të identifikojnë mangësitë dhe të ndërmarrin veprime korigjuese. Ky auditim përfaqëson punën më efektive të Auditimit të brendshëm, sepse, nëse kontrollet operojnë ashtu siç është parashikuar, atëherë Audituesit e brendshëm dhe niveli i menaxhimit të organizatës mund të marrin siguri nga kontrollet e vendosura (Ministria e Financave të Shqipërisë, 2010).

Auditimi i përputhshmërisë. Auditimi i përputhshmërisë përfaqëson ekzaminimin e veprimtarive të subjektit, në procesin e realizimit të objektivave, në këndvështrimin e përputhjes së tyre me ligjet dhe rregullat. Auditimet e përputhshmërisë kanë për qëllim të testojnë nëse organizata vepron në përputhje me legjislacionin përkatës të fushës (*Ministria e Financave të Shqipërisë, 2010*).

Auditimi i performancës. Auditimi i performancës, ose i vlerës së parave, është procesi i vlerësimit të objektivave, programeve dhe shkallës së realizimit të tyre, në lidhje me kursimin, dobinë dhe frytshmërinë:

- Kursimi është përdorimi me masë dhe me kujdes i burimeve për një veprimtari, duke ruajtur cilësinë e nevojshme.
- Dobia nënkupton lidhjen ndërmjet rezultatit, në kuptimin e mallrave, shërbimeve ose prodhimeve të tjera (rezultateve) dhe burimeve të përdorura për t'i prodhuar ato.
- Frytshmëria nënkupton nivelin e realizimit të objektivave dhe marrëdhëniet ndërmjet rezultatit të pritur dhe rezultatit faktik të veprimtarisë.

Një auditim performance ekzaminon cilësinë e shërbimit të kryer dhe nëse ky shërbim shton “vlerë për para”. Për shembull, Audituesit e Brendshëm mund të shqyrtojnë cilësinë e shërbimit të transportit publik, në një qytet dhe, e vlerësojnë këtë cilësi në raport me koston. Auditimet e performancës, zakonisht, përfshijnë krahasimin e informacionit të koston të shërbimit dhe mundësimin e shërbimit nga organizata të tjera të ngjashme (*Ministria e Financave të Shqipërisë, 2010*).

Auditimet financiare. Auditimet financiare kryhen për të vlerësuar saktësinë dhe plotësinë e regjistrimeve dhe gjendjeve të llogarive. Auditimet financiare përdorin teste thelbësore, rishikime analitike dhe procedura të tjera vlerësimi të cilat mund të përfshijnë ose të mos përfshijnë testet funksionale apo rishikime të transaksioneve. Auditimet financiare përcaktojnë nëse informacioni financiar i subjektit publik paraqet në mënyrë të besueshme pozitën financiare, rezultatet e operacioneve dhe shmangiet e subjektit të audituar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit Publik. Procedurat e Auditimit financiar janë më të detajuara në Metodikën e Auditimit financiar (*Ministria e Financave të Shqipërisë, 2010*).

Auditimet e Teknologjisë së Informacionit (TI). Një auditim i TI fokusohet vetëm në kontrollet e vendosura në një organizatë. Ky lloj auditimi mund të përfshijë auditimin e të gjithë kontrolleve të sistemit të TI në një organizatë ose vetëm të një fushe të organizatës, si për shembull, të fushës së llogarisë. Auditimet e TI më shpesh bëhen kur në një fushë të veçantë llogarie është vendosur një sistem i ri. Megjithëse ky manual mbulon disa aspekte të auditimit të TI, duhet pasur parasysh se një auditim i tillë është një fushë shumë e specializuar dhe mbetet jashtë objektivit të këtij manuali për Auditimin e Brendshëm (*Ministria e Financave të Shqipërisë, 2010*).

Angazhimet e Auditimit për këshillim. Një angazhim këshillues është shqyrtimi i sistemeve dhe ka për qëllim përmirësimin e kontrolleve ekzistuese. Krahasuar me auditimet me bazë sistemi, angazhimi këshillues është më i kufizuar pasi nuk teston kontrollet e brendshme ekzistuese, por thjesht vëren projektimin/ndërtimin e sistemit që shqyrtohet (*Ministria e Financave të Shqipërisë, 2010*).

Angazhimet e auditimit për Shërbim konsulence. Audituesit e Brendshëm kur kryejnë shërbim konsulence veprojnë në kapacitetin e këshilluesit për nivelin e lartë të menaxhimit në një organizatë. Një gjë e tillë do të thotë se Audituesit e Brendshëm kanë një rol këshillues aktiv në një fushë të caktuar dhe jo vetëm të rishikojnë në mënyrë të pavarur atë që u ka propozuar menaxhimi. Duhet të tregohet kujdes kur bihet dakord për të ndërmarrë një lloj pune të tillë me qëllim që të mos komprometohet pavarësia e audituesit të brendshëm. Do të ishte e pamundur për audituesit e brendshëm të auditonin një fushë të llogarisë në mënyrë objektive nëse ata janë shumë të përfshirë në krijimin apo hartimin e kësaj fushe/veprimtarie. Kontraktimi i këtij shërbimi dhe mënyra e pagesës rregullohen me Urdhër të Ministrit të Financave (*Ministria e Financave të Shqipërisë, 2010*).

2.5 Roli i auditorit të brendshëm

Departamenti i auditimit të brendshëm ka një rol dyfish në lidhje me menaxhimin e riskut:

- Ai monitoron politikën e përgjithshme të kompanisë për menaxhim të rrezikut për t'u siguruar se kompania funksionon në mënyrë efektive.

- Ai monitoron strategjitë e zbatuara për të siguruar që ato të vazhdojnë të funksionojnë në mënyrë efektive.

Auditimi i brendshëm ka një rol kyç në vlerësimin e sistemeve dhe testimin e kontrolleve. Auditimi i brendshëm mund të ndihmojë në zhvillimin e sistemeve. Megjithatë, roli i tij do të jetë kyç në monitorimin e procesit të përgjithshëm dhe në ofrimin e sigurisë së sistemit.

Auditorët e brendshëm me paanshmëri e ekzaminojnë dhe vlerësojnë sistemin e kontrollit të brendshëm si një shërbim ndaj organizatës. Në organizatat e mëdha, një shërbim ose departament i auditimit të brendshëm zakonisht integrohet brenda strukturës së departamentit të financave. Përgjegjësia e auditorit të brendshëm i dedikohet menaxhmenti të organizatës të cilit ata i raportojnë (*ACCA, 2011*).

Detyrat më tipike të auditimit të brendshëm mund të përmbliken si më poshtë:

1. Vlerësimi i përputhjes së aktiviteteve të biznesit me politikat e brendshme dhe procedurat e miratuara.
2. Dhënia e këshillave për hartimin e politikave të brendshme, së bashku me udhëzimet dhe procedurat.
3. Vlerësimi i kontrolleve lidhur me ruajtjen e kapitaleve.
4. Vlerësimi i zhvillimit të veprimtarisë në përputhje me standardet ligjore.
5. Vlerësimi i kontrolleve të brendshme mbi veprimtarinë financiare.
6. Vlerësimi i kontrolleve të brendshme në proceset e biznesit.
7. Vlerësimi i proceseve të identifikimit, vlerësimit dhe menaxhimit të riskut.
8. Vlerësimi i efikasitetit operacional.
9. Vlerësimi i përmbushjes së detyrimeve kontraktore.
10. Vlerësimi i auditimeve të teknologjisë dhe të informacionit.
11. Investigimi i mashtrimeve (*Ministria e Financave, 2011*).

Auditimi i brendshëm është si një shtet i pavarur. Duke qenë i pavarur, auditimi i brendshëm ndihmon organizatën në përmbushjen e objektivave të saj duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të riskut, kontrollit dhe proceseve të qeverisjes së auditimit të brendshëm. Aktivitetet e auditimit të

brendshëm kryhen në mjedise të ndryshme ligjore dhe kulturore, brenda organizatave që ndryshojnë nga qëllimi, madhësia, dhe struktura dhe nga persona brenda apo jashtë organizatës (*Sawyer, 1993*).

Auditimi i brendshëm (AB) shërben si një lidhje e rëndësishme në proceset e biznesit dhe të raportimit financiar të korporatave dhe ofruesve jo-fitimprurës. Auditorët e brendshëm luajnë një rol kyç në monitorimin ose profilin e një kompanie të rrezikut dhe identifikimin e fushave për të përmirësuar menaxhimin e riskut. Qëllimi i auditimit të brendshëm është për të përmirësuar efikasitetin organizativ dhe efektivitetin nëpërmjet kritikës konstruktive.

Auditimi i brendshëm (AB) ka katër komponentë kryesore:

- Verifikimin e të dhënave të shkruara
- Analizën e politikës
- Vlerësimin e logjikës dhe plotësimin e procedurave, shërbimet e brendshme të stafit për të siguruar që ata janë të efektshme dhe të përshtatshme për politikën e organizatës dhe,
- Rekomandimet dhe raportimet për përmirësime në menaxhim (*Sawyer, 1993*).

Auditorët e brendshëm janë të rëndësishëm, madje edhe vendimtarë, në një ekonomi që mbështetet në informacionin e prodhuar në mënyrë të pavarur. Në të vërtetë auditimi i brendshëm (AB) është bërë një mjet i domosdoshëm i menaxhimit për të arritur kontroll efektiv në të dy organizatat publike dhe private. Të kuptuarit e faktorëve që përcaktojnë efektivitetin e auditimit të brendshëm është i rëndësishëm sepse auditimi i brendshëm është efektiv dhe mund të përmirësojë katër procese të rëndësishme në organizatë, si:

- Të mësuarit (anëtarët mësojnë se si të bëjnë punën e tyre më të mirë)
- Motivimi (auditimi çon në përmirësimin e performancës si mangësi do të duhet të shpjegohet)
- Përmbajtje (duke e ditur se një auditim është i pashmangshëm mund të dekurajojë abuzimin)
- Përmirësimet e procesit (mund të rrisë gjasat që gjërat e duhura janë bërë dhe se ato janë bërë në mënyrë të drejtë) (*Sawyer & Dittenhofer, 1981*).

2.5.1 Përgjegjësia për mashtrime dhe gabime

Është përgjegjësi e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për të parandaluar dhe zbuluar mashtrimin, dhe në këtë drejtim, auditorët e brendshëm kanë një rol të rendësishëm.

Mashtrimi është një rrezik kryesor për biznesin. Sikurse auditori i brendshëm ka një rol në menaxhimin e riskut ai është i përfshirë në procesin e menaxhimit të rrezikut të mashtrimit. Nuk është përgjegjësia e auditorëve të jashtëm për të parandaluar dhe zbuluar mashtrimin, edhe pse ata mund të zbulojnë mashtrimin si pjesë e tyre të auditimit të pasqyrave financiare, dhe ata do të jenë të vetëdijshëm për rreziqet e mashtrimit, ndërsa kryerjnë auditimin.

Ekzistenca e një departamentit të auditimit të brendshëm mund të veprojë si një pengesë për mashtrim. Auditorët e brendshëm gjithashtu mund të thirren për të ndërmarrë projekte të posaçme për të hetuar një mashtrim të dyshuar (*The Center of Excellence in Finance, 2010*).

2.5.2 Kufizimet në funksionin e Auditit të brendshëm

Ndonëse prania e një departamentit të auditimit të brendshëm brenda një organizate është tregues i mirë i kontrollit të brendshëm, nga natyra e tij, ka disa kufizime të funksionit të auditimit të brendshëm.

Auditorët e brendshëm janë të punësuar nga organizata dhe kjo mund të pengojë pavarësinë, objektivitetin dhe aftësinë e tyre dhe për të raportuar mashtrimin/gabimin tek menaxhmenti i lartë për shkak të kërcënimeve të perceptuara ndaj punësimit të tyre të vazhdueshme në kuadër të kompanisë.

Për të siguruar transparencë, praktika më e mirë tregon se funksioni i auditimit të brendshëm duhet të ketë një marrëdhënie të dyfishtë të raportimit, që dmth auditorët e brendshëm raportojnë edhe tek menaxhmenti edhe ata të ngarkuar me qeverisje (komiteti i auditimit). Nëse kjo strukturë raportuese nuk është në vend, menaxhmenti mund të jetë në gjendje të ndikojë padrejtësisht planin e auditimit të brendshëm, shtrirjen, dhe nëse çështjet janë raportuar drejt. Kjo rezulton në një konflikt serioz, kufizon fushëveprimin dhe komprometon efektivitetin e funksionit të auditimit të brendshëm (*ACCA, 2011*).

2.6 Rregullativat e Auditimit të Brendshëm në Kosovë

Auditorët e brendshëm kanë mundësi të qasjes në të gjitha dokumentet, informatat dhe në pasurinë e kompanisë në mënyrë që të kenë të dhëna sa më shumë që të realizohet synimi i auditimit, pra auditorët duhet të jenë të përgatitur dhe t'i njohin rregullat e auditorit të brendshëm.

Aktiviteti i auditimit të brendshëm rregullohet me strategji, ligje mbi auditimin e brendshëm, udhëzime administrative, kode e standarte të auditimit, të paraqitura si në vijim:

1. Strategjia për funksionin e Auditimit të Brendshëm në Kosovë,
2. Ligji mbi Auditimin e Brendshëm 03/L128 17 Shtator, 2009,
3. Udhëzimi Administrativ 23/2009 mbi themelimin dhe funksionimin e Njësive të Auditimit të Brendshëm,
4. Udhëzimi Administrativ 22/2009 për përcaktimin e kritereve dhe procedurën e paisjes me licencë të përkohshme të Auditorit të brendshëm në sektorin public,
5. Udhëzimi Administrativ nr.11/2010 për themelimin dhe funksionimin e komiteteve të auditimit në sektorin e subjektit public,
6. Kodi i Etikës së Auditorëve të Brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës,
7. Standardet e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik të Kosovës,
8. Statuti Model për Njësitë e Auditimit të Brendshëm (*Ministria e Financave, 2011*).

2.7 Parimet e Përgjithshme të Funksionimit të Auditimit të Brendshëm

Parimet e auditimit të brendshëm duhet të respektohen dhe të mbështeten nga të gjitha njësitë e auditimit të brendshëm dhe auditorët e tyre, ato janë:

- **Ligjshmëria.** Është njëri ndër parimet më të vjetra nga i cili fillon dhe hulumton pajtueshmërinë e gjendjes reale me atë ekzistuese të dispozitave ligjore. Veprimtaria e auditimit parashihet me ligje dhe rregullore që rrjedhin nga Kushtetuta e Kosovës, të cilat kanë karakter obligativ dhe duhet të zbatohen me përpikshmëri.

- **Integriteti.** Ky parim obligon njësitë e auditimit të brendshëm dhe auditorët e tyre që veprimtaria e auditimit të kryhet konform ligjit, të shmangen konfliktet e interesit dhe të mos ndikohen nga mënyra e veprimtarisë nga interesat personale.
- **Objektiviteti.** Sikurse veprimtaritë tjera që synojnë realizimin e objektivave të tyre, edhe auditimi i brendshëm kërkon përkushtim profesional dhe aktivitet maksimal për të realizuar sa më shumë të dhëna në mënyrë që rezultatet e auditimit të paraqiten si objektiva të realizuara në mënyrë sa më të rregullt.
- **Besueshmëria.** Ruajtja e konfidencialitetit përpos në rastet e parapara me ligj është parim fundamental i auditimit të brendshëm, i cili e nxjerr në pah pozitivitetin e veprimtarisë së auditimit dhe krijon nivel të lartë të besueshmërisë nga ana e palës që auditohet.
- **Paanësisë.** Është pasqyrimi objektiv dhe transparent në dokumentet përkatëse i të gjitha fakteve dhe rrethanave, që lidhen me veprimtarinë e subjekteve të audituara, pa u ndikuar nga interesi personal ose pikëpamjet e udhëheqësve.
- **Pavarësisë.** Është ushtrimi i veprimtarisë për përcaktimin, planifikimin, realizimin dhe raportimin e veprimtarisë së auditimit, jashtë çdo ndikimi që ka lidhje me veprimtarinë e audituar apo rrethanat, që cenojnë apo mund të cenojnë objektivitetin dhe mos të ketë ndikim nga vetë individët.
- **Raportimi korrekt.** E obligon audituesin që të përmbahet nga deklarimi (dhënia e mendimit) kur për këtë nuk ekzistojnë mundësitë dhe kushtet e nevojshme. Pengesat që has më së shpeshti audituesi në dhënien e mendimit mund të jenë:
 1. Pamundësia në qasjen e dokumentacionit të nevojshëm
 2. Mundësitë e kufizuara të hulumtimit (*Jakupi & Krasniqi, 2012*).

2.8 Hapat gjatë procesit të auditimit të brendshëm

2.8.1 Planifikimi

Gjatë pjesës së planifikimit të auditimit, auditori krijon kushtet e angazhimit me audituesit, njofton bordin e auditimit, mbledh informacione mbi proceset e rëndësishme, vlerëson

kontrollet ekzistuese, si dhe përgatit planin e auditimit. Bëhet një plan vjetor se çfarë fusha do të auditohen gjatë vitit kalendarik. Nganjëherë jo të gjitha fushat mund të mbulohen gjatë një viti kalendarik, në mungesë të stafit apo metodologjisë së auditimit. Nganjëherë synohet mbulimi i të gjitha fushave (që janë të aplikueshme për një biznes) brenda një cikli 2 vjeçar apo 3 vjeçar. Në këtë fazë përfshihen:

- a) *Ekipi Angazhues*. Në këtë fazë, Audituesi i lartë do të kontakton stafin të cilët do të kryejnë auditimin, për t'iu dhënë atyre një përshkrim të shkurtër në lidhje me kontaktet e mëparshme dhe historinë me funksionin e auditimit të brendshëm, duke përfshirë gjetjet e mëhershme, kohëzgjatjen në auditimin e kaluar, rezultatet e vlerësimit të rrezikut dhe fushëveprimin paraprak të auditimit.
- b) *Letra Angazhuese*. Auditori do të përgatisë një “Letër Ndihmëse” me kërkesat e përgjithshme që do të auditohen, shembujt e kërkesave gjeneral janë: lista e tabelave, rrëfimet e proceseve, tabelat organizative, udhëheqësit e departamenteve dhe ndryshimet e fundit në procese.
- c) *Hulumtimi paraprak i Dokumentacionit*. Për të rritur efikasitetin e planifikimit dhe të përshpejtojë procesin e zhvillimit të programit, audituesi mund të kërkojë disa pyetje të përgjithshme për një kuptim më të mirë të proceseve, p.sh pyesin për kopjet ose dërgimin me email të politikave dhe procedurave. Auditori mbledh informatat relevante në lidhje me subjektin e auditimit në mënyrë që të marrë një pasqyrë të përgjithshme të operacioneve. Auditori diskuton me personelin kyç dhe shqyrton burimet e informacionit. Ky proces mund të bëhet nëpërmjet telefonit ose e-mailit.
- d) *Njoftimi*. Auditori do të konfirmojë me kreun e departamentit të audituar (ose shefat e departamenteve, nëse më shumë se një departament do të përfshihen në të njëjtën periudhë), me shkrim (p.sh. përmes emailit), kohën dhe qëllimin e punës së auditimit që do të kryhet (pasi që është rënë dakord tashmë në letrën e angazhimit).
- e) *Njoftimi me rishikimin e proceseve dhe kontrolleve të brendshme*. Gjatë këtij hapi, auditorët do të njoftohen me kuptimin e proceseve dhe politikave të njësisë që auditohen. Nëse ky nuk është auditimi i parë i njësisë, auditori do të përmirëson procesin me ndryshimet/përmirësimet që kanë ndodhur gjatë auditimit të fundit, si është akorduar me udhëheqësit e proceseve. Rishikimi mund të përbëhet nga një ose

më shumë kombinime të mëposhtme: intervista me pyetje me drejtuesit e njësisë / apo personelin që kryesisht janë duke kryer detyrat, rishikimi i dokumentacionit të përdorur për proceset, listat e tabelave, etj.

- f) *Programi i Auditimit*. Programi i auditimit nxjerrë në përfundim fazën e planifikimit. Kjo do të përshkruaj punën në terren që do të performoj për të arritur objektivat (*Sawyer, 1993*).

2.8.2 Puna në terren

Faza në terren përqendrohet në testimin e transaksionit dhe komunikimit. Ajo përfundon me një listë të gjetjeve të rëndësishme nga të cilat auditori përgatit një draft të raportit të auditimit. Bëhet shpallja e auditimit. Njoftohen të gjithë personat e involvuar, dhe menaxhmenti. Dërgohet një njoftim nga udhëheqësi i ekipit për fillimin e auditimit në fjalë, dhe kohën/periudhën e auditimit, sa do të zgjasë, dhe çfarë aspekte do të mbulohen. Negociohet koha dhe periudha. Ndodh të shtyhet për arsye të jashtëzakonshme. Në këtë fazë përfshihen:

- a) *Takimi fillestar*. Gjatë këtij takimi, i audituari përshkruan njësinë apo sistemin që do të rishikohet, burimet në dispozicion dhe informata tjera relevante. I audituari identifikon çështjet ose fushat me shqetësim të veçantë që duhet të adresohen. Gjatë këtij takimi, mund të diskutohen çështje të ndryshme si: prezantimi i ekipit dhe personelit të klientit, standardet e komunikimit me klientin (ditore/javore, komunikimi i pikave të pazgjidhura, diskutimi i çështjeve dhe gjetjet etj), mandati i kohëzgjatjes dhe rikonfirmimi i qëllimit të angazhimit, si dhe të shpjegojë çështjet që do të ndjekin.
- b) *Testimi i transaksionit*. Në këtë fazë transaksionet do të testohen duke përdorur teknika të ndryshme, duke përfshirë marrjen e mostrave. Qëllimi i testimit për auditorin është që të vlerësojë nëse hapat e përmendura të kontrolleve në "Rishikimin e proceseve dhe kontrolleve të brendshme" po veprojnë në mënyrë efektive. Kërkohen dëshmi për çdo detaj që diskutohet, p.sh. "pasqyrë" të konfigurimit të sistemeve të informacionit, vetë konfigurimet (nëse është auditim teknik),

përdoruesit, nëse zbatohet parimi i 4 syve, a ka ndarje të drejtë të punës, a ka konflikte, a ka mundësi mashtrimesh, a lihen gjurme gjatë veprimeve etj.

- c) *Komunikimi i vazhdueshëm.* Pasi që puna në terren është kryer, auditori do të diskutojë ndonjë gjetje të rëndësishme me pronarët e proceseve. Në të njëjtën kohë, pronarët e proceseve do të kenë mundësinë për të diskutuar me auditorin e kontrollit kompensues, po ashtu edhe dokumentacionin mbështetës. Auditori gjithashtu do të informojë klientin për përparimin e auditimit gjatë gjithë procesit. Zakonisht komunikimi do të jetë me gojë, me shkrim ose me email, memorandume për çështjet më komplekse për të siguruar mirëkuptim të plotë nga ana e klientit dhe auditorit.
- d) *Takimi përfundimtar.* Pas përfundimit të punës në terren, auditori do të takohet me klientin për të diskutuar gjetjet paraprake dhe rekomandimet e propozuara. Ky takim jep mundësi për të dyja palët për të rënë dakord me rekomandimin më të realizueshëm dhe për të shmangur ndonjë surprizë të pakëndshme gjatë fazës së raportimit (Sawyer, 1993).

2.8.3 Periudha Raportuese

Kjo fazë ka të bëjë me principin e auditimit. Ajo shpreh opinionin e auditorit, paraqet gjetjet e auditimit dhe diskuton rekomandime për përmirësime. Bazuar në dëshmitë e mësipërme krijohet një raport draft, i cili rishikohet nga disa palë brenda njësisë së auditimit të brendshëm, si p.sh udhëheqësi i departamentit ose ndonjë koordinator.

Gjatë raportimit ceken.

- a) *Raporti paraprak i Auditimit.* Pasi skedari është shqyrtuar, auditori do të përgatisë draft raportin e auditimit të brendshëm duke nënvizuar subjektet e audituara, fushëveprimin e punës, rekomandimet dhe afatet kohore të rekomanduara për zbatimin e tyre.
- b) *Përgjigjja e Menaxhmentit.* Menaxhmenti në departamentin e audituar do të përgatisë një përgjigje ndaj gjetjeve të auditimit në raportin e auditimit. Përgjigjja (plani i veprimit) do të përfshijë: titullin e personit përgjegjës për zbatim, veprimet që do të merren dhe afatin kohore për zbatim. Përgjigjja do të dërgohet tek auditori.

- c) *Raporti Final*. Kur përgjigjja e menaxhmentit është inkorporuar në draft raportin e auditimit, raporti bëhet përfundimtar. Auditori do të paraqes raportin përfundimtar komisionit të auditimit. Kopjet do t'u shpërndahen udhëheqësve të audituar apo departamentit (*Sawyer, 1993*).

2.8.4 Periudha Rivlerësuese

Pas një periudhe rishikohen zgjidhjet e gjetjeve dhe shihet në praktike a janë realizuar apo jo. Nëse jo, bëhet rivlerësimi i situatës momentale dhe rrezikut (nëse nuk ka ndryshuar nga hera e kaluar).

- a) *Rishikimi Ndjekës*. Ka mundësi që pas rishikimit gjetjet nuk qëndrojnë më, për shkak se kanë ndryshuar kushtet, apo nuk ka rrezik më, për shkak të ndryshimit të ambientit të punës, dhe ai rishikim është jo relevant pas një kohe - në këtë rast 'gjetjet' mbyllen pa u realizuar sipas pajtimit. Gjate rishikimit ndodh të kërkohen dokumente sërish, sikur të ishte auditim nga fillimi.
- b) *Raportimi Ndjekës*. Një raport ndjekës do t'i lëshohet menaxhmentit, dhe një kopje do t'i dërgohet Audituesit, duke përshkruar çështjen e ndjekur për zbatimin e kontrollit të menaxhmentit, vlerësimin e përshtatshmërisë së kontrollit dhe një listë me gjetjet e pazgjidhura, duke përfshirë afatin e tyre të fundit (*Sawyer, 1993*).

3. DEKLARIMI I PROBLEMIT

Qëllimi i këtij punimi është ofrimi dhe akselerimi i njohurive rreth rëndësisë së auditimit të brendshëm dhe përfitimit nga auditimi i brendshëm që i kanë kompanitë të cilat veprojnë në Kosovë, a janë duke i dhënë rëndësi këto kompani auditimit të brendshëm, a arrijnë efektivitetet në akvitetet e tyre nga rekomandimet e auditimit të brendshëm dhe a kanë njohuri konkrete për atë se çfarë në të vërtetë mund të arrijnë për profitin, reputacionin, kredibilitetin dhe shtimin e palëve të treta për kompaninë e tyre përmes auditimit të brendshëm.

Përmes këtij hulumtimi janë mbledhur informacione të cilat qojnë në një përfundim se sa i rëndësishëm është auditimi i brendshëm, cilat janë përfitimet e auditimit të brendshëm për kompanitë dhe cili është ndikimi që luan ky funksion në efektivitetin dhe efikasitetin e kompanive. Përmes auditimit të brendshëm ndërmarja ndihmohet në përcaktimin e problemeve, dhe mbi këtë bazë, rezultatet e auditimit të brendshëm, i ndihmojnë bordet/organet vendimmarrëse të marrin masat e duhura në mënyrë që të kalojnë sa më lehtë problemet e paraqitura dhe të parandalojnë sa më shumë nga problemet që mund të shfaqen në të ardhmen.

Hulumtimi është i koncentruar më së shumti në sektorin privat dhe për qëllim kryesor ka arritjen në përfundim se sa kanë arritur kompanitë kosovare të funksionalizojnë rolin e auditorit të brendshëm dhe nëse po, a i'u ka ndihmuar në arritjen e qëllimit strategjik të tyre.

4. METODOLOGJIA

Për rezultatin e këtij punimi është përdorur një metodologji kualitative e hulumtimit që konsiston në mbledhjen e të dhënave sekondare. Të dhënat sekondare janë rezultat i rishikimit të literaturave të gjëra mbi rëndësinë e auditimit të brendshëm për përfitim të bizneseve, të cilat kanë shërbyer për ndërtimin e kuadrit teorik dhe hulumtimit të realizuar.

Është bërë një analizë për evoluimin e auditimit, definimin e auditimit, auditimin e brendshëm si një nga llojet e auditimit. Pastaj është thelluar në analizë për llojet e auditimit të brendshëm, hapat gjatë procesit të auditimit të brendshëm, rolin e auditorit të brendshëm dhe përgjegjësinë e tyre për mashtrime dhe gabime, kufizimet që i kanë ata gjatë funksionit të tyre dhe parimet e përgjithshme në të cilat bazohet funksionimi i auditimit të brendshëm.

Në vazhdim për të arritur në një konkluzion se sa i rëndësishëm është auditimi i brendshëm për përfitim të bizneseve është realizuar një hulumtim kuantitativ duke përdorur metodën e pyetësorit, ku ky pyetësor u është bërë disa kompanive në Kosovë.

Përmes pyetësorit do të vërejmë sa i rëndësishëm është auditimi i brendshëm për bizneset në Kosovë dhe cilat janë përfitimet që i kanë bizneset Kosovare nga auditimi i brendshëm. Pyetësori është përgatitur dhe dërguar tek departamenti i udhëheqjes nëpër kompanitë e listuara mëposhtë dhe është synuar që të arrihet kontakt direkt me drejtuesit e këtyre departamenteve në mënyrë që të fitojmë përshtypjet më të sakta rreth këtij diskutimi.

Përcaktimi që të dërgohen pyetësorët tek pozitat menaxhuese, ka bërë që jo të gjithë pyetësorët të plotësohen. Nga 20 pyetësor të dërguar në adresa të ndryshme, vetëm shtatë prej tyre të listuara më poshtë janë kthyer të plotësuara: Raiffeisen Bank, Banka Ekonomike e Kosovës, Banka Botërore, Banka për Biznes, TEB Sh.A, Meridian Corporation dhe Buqaj.

5. PREZANTIMI DHE ANALIZA E REZULTATEVE

Në këtë kapitull diskutohen rezultatet e fituara nga literatura e shqyrtuar dhe rezultatet empirike nga pyetësi për pyetjet konkrete.

Në bazë të pyetësorit që është realizuar për drejtuesit e kompanive, të departamenteve apo të degëve përkatëse në institucionet në Kosovë është arritur në përgjigjen e pyetjes kërkimore. Këto rezultate na tregojnë se auditimi i brendshëm sjell përfitime për bizneset dhe është përparësi për bizneset në të cilat aplikohet.

Auditimi i brendshëm është pjesa integrale e sistemit të kontrollit të brendshëm të kompanisë, ndonëse kontrolli i brendshëm është më i gjërë me qëllim dhe përmbajtje që synon të shtojë vlerat dhe të përmirësojë aktivitetin e kompanisë, pra ndihmon kompanitë të arrijnë objektivat e saj nëpërmjet hyrjes së një trajtimi sistematik të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efikasitetin e menaxhimit të riskut, kontrollin dhe procesin e udhëheqjes sa më të mirë të kompanive.

Auditimi i brendshëm është një aktivitet i pavarur për të ofruar siguri objektive dhe këshilluese, i dizajnuar që të shtojë vlerën dhe të përmirësojë operacionet e organizatës. Ai i ndihmon organizatës në përmbushjen e objektivave të saj duke sjellë një qasje sistematike, të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e efikasitetit të procesit të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Çdokush i cili ka një numër të personelit, funksioneve, lokacione të zyrave ose sisteme teknike që ai / ajo nuk është personalisht dhe operues i vetëm, mund të tejkalojë rrezikun e gabimeve apo parregullsive që ndodhin në biznesin e tyre. Është gjithashtu e dëshirueshme për të kontrolluar dhe parandaluar mashtrimin duke kryer një kontroll të rregullt.

Disa nga përfitimet kryesore që Auditimi i Brendshëm i sjell bizneseve janë:

- a) Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve: Auditimi i brendshëm ndihmon kompanitë të identifikojnë rreziqet dhe pengesat që ata mund të hasin në rrugën për të arritur

objektivat e tyre të biznesit. Auditimi i brendshëm gjithashtu vlerëson gjasat në materializimin e rrezikut dhe pasojat e tij të mundshme, duke i dhënë një perspektiv asaj që rreziqet janë "të rëndësishme" dhe për këtë arsye kërkojnë vëmendje më urgjente. Auditimi i brendshëm mund të ndihmojë kompanitë të jetë më mirë të përgatitura për të parandaluar ngjarje të caktuara negative që ndodhin dhe gjithashtu për të siguruar një përgjigje adekuate duhet të ndodhin ngjarje të tilla. Kjo do të thotë se një organizatë ka të ngjarë të përballet me pak surpriza apo situatat e krizave dhe të përgatiten më mirë për shumicën e eventualiteteve.

- b) Vlerësimi – Kontrolli: Kompanitë mund të vlerësojë nëse kontrollet dhe procedurat që kanë vënë në vend janë të përshtatshme për të zbutur rreziqet e identifikuara. Kjo u mundëson kompanive për të përmirësuar procedurat e kontrolleve dhe të bëjnë korrigjimet e kursit ku është e nevojshme. Vlerësimi i kontrolleve përmes ekspertëve në këtë fushë mund të ndihmojë në boshllëqet e korrigjuara në kontrollet e brendshme madje mund të çojë në parandalimin dhe zbulimin e aktiviteteve mashtruese.
- c) Sigurimin e pajtueshmërisë me rregulloret: Pajtueshmëria me rregullat, si dhe politika e brendshme dhe procedurat janë një rezultat i rëndësishëm i përfshirjes së auditimit të brendshëm. Një fokus i vazhdueshëm në këtë lami nëpërmjet funksionit të auditimit të brendshëm mund të ndihmojë në menaxhimin e kompanisë po ashtu përmes këtij auditimi e promovojmë kulturën e "vetëdijes pajtueshmërisë", ku përputhja ndodh si pjesë e punës së përditshme të gjithëve e jo si një proces i veçantë.
- d) Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të proceseve: Kur menaxhimi i zgjeron fushëveprimin e auditimit të brendshëm për të përfshirë vlerësimin e rrezikut të ndërmarrjes, kjo mund të rrisë efektivitetin dhe efikasitetin e proceseve duke identifikuar dyfishimin dhe aktivitetet të tepërta.
- e) Sigurojnë ngushëllim për menaxhimin, bordin dhe aktorë të tjerë: Një nga përfitimet më të rëndësishme të auditimit të brendshëm është që të ofrojë siguri për menaxhimin dhe një nivel në rehati të komitetit të Auditimit, Bordit të Drejtorëve dhe aktërëve të jashtëm që kompania ka një të fortë siç është mjedisi i kontrollit që mjaftueshëm zbut

rrezikun që një kompani mund të jetë ekspozuar ndaj edhe kontribuon në arritjen e objektivave të biznesit.

Përfitime tjera nga Auditimi i Brendshë janë:

- Ndhmon në procesin vendimmarrës të bizneseve duke zvogëluar rrezikun për gabime;
- Identifikon rreziqet e mundshme për arritjen e ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit;
- Analiza dhe të kuptuarit e shënimeve financiare të kompanisë.
- Identifikohen fushat kyçe për përmirësim në kompani.
- Zbulon veprimtari mashtruese ose të tjera të paligjshme brenda kompanisë.
- Fuqizimin dhe forcimin e kontrollit të brendshëm.
- Një auditim ndihmon për të identifikuar dobësitë në sistemet e kontabilitetit dhe na mundëson që të sugjerojmë përmirësime. Procesi i tillë i mban të informuar partnerët e zonave / situatat ku këshilla është e dobishme;
- Një auditim siguron drejtorë të cilët nuk janë të përfshirë në funksionet e kontabilitetit në një bazë ditë-për-ditë që tregon se biznesi është duke u zhvilluar në përputhje me informacionin që ata janë duke e pranuar, dhe ndihmon në zvogëlimin e fushës për mashtrim dhe kontabilitet dobët;
- Një auditim lehtëson ofrimin e këshillave që mund të ketë përfitime reale financiare për një biznes, duke përfshirë rrjedhën e zhvillimit të biznesit, çfarë kufijë mund të arrihen dhe se si mund të arrihen. Këshilla mund të mbulojë çdo gjë nga shtrëngimi i kontrolleve të brendshme, për të zvogëluar rrezikun e mashtrimit apo planifikimin e taksave;
- Një auditim do të rrisë kredibilitetin dhe besueshmërinë e shifrave të paraqitura të blerësve të ardhshëm. Nëse një menaxher pronar është duke planifikuar mbi shitjen në 3 vitet e ardhshme, ajo mund të jetë e dobishme për të kryer auditime të rregullta;
- Një auditim mund të jetë i dobishëm në qoftë se një kompani është në rritje dhe ka të ngjarë të kalojë pragun e qarkullimit në të ardhmen e afërt, në mënyrë që të shmang rishqyrtimin e shifrave të viteve të mëparshme, pasi pragu është arritur;

- Një auditim shton kredibilitetin e informatave të publikuara për punonjësit, klientët, furnizuesit, investitorët dhe autoritetet tatimore;
- Auditimi ofron siguri për aksionarët (në qoftë se ata nuk janë drejtorë të përfshirë ngushtë në biznesin) se shifrat në llogari tregojnë një pamje të vërtetë dhe të drejtë
- Identifikon tepricat në procedurat operacionale dhe të kontrollit dhe jep rekomandime për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të procedurave;
- Shërben si një sistem paralajmërues, duke bërë të mundur që mangësitë të identifikohen dhe eliminohen në kohë (d.m.th rregullatore ose auditimeve të pajtueshmërisë);

Benefitet që marrin bizneset nga auditimi i brendshëm cilësohen si përparësi e atij biznesi dhe ndihmojnë në zhvillimin e mëtutjeshëm të kompanisë.

Roli i auditorit të brendshëm është ti ndihmojë anëtarët e kompanisë ti kryejnë përgjegjësitë e tyre duke i pajisur (apo siguruar) ata me analiza, vlerësime, rekomandime dhe këshilla. Në kryerjen e këtyre funksioneve, auditorët e brendshëm mund të konsiderohen si pjesë e kontrolleve të brendshëm të kompanisë, pra auditorët e brendshëm përfaqësojnë kontroll të nivelit të lartë të cilët funksionojnë nëpërmjet matjes dhe vlerësimit të efektivitetit të kontrolleve tjera. Puna e tyre përfshin të gjitha kontrollet e kompanisë dhe vlerësojnë, testojnë efektivitetin e kontrolleve të dizajnuar për ti ndihmuar kompanisë në arritjen e të gjitha objektivave të saj. Gjithashtu, shumë departamente të auditimit të brendshëm i ofrojnë menaxhmentit të kompanisë edhe shërbime të shumta të sigurisë dhe këshillëdhënies.

Auditimi mund të përmirësojë efikasitetin e një kompanie dhe profitabilitetin duke ndihmuar të kuptojmë më mirë rreth menaxhimit të punës dhe sistemeve të tyre financiare. Menaxhmenti, si dhe aksionarët, furnizuesit dhe financuesit, janë gjithashtu të sigurt se rreziqet në organizatën e tyre janë të mirë-studiuar, dhe sistemet efektive janë në vend për të trajtuar ato.

Auditimet gjithashtu mund të identifikojnë fushat në strukturën financiare të organizatës që kanë nevojë për përmirësim, dhe si të zbatoj ndryshimet dhe rregullimet e duhura. Duke pasur një auditim gjithashtu zvogëlon rrezikun dhe koston e kapitalit.

Një auditim mund të zbulojë pasaktësitë dhe mospërputhjet brenda regjistrave të organizatës, të cilat mund të jenë indikacione të organizimit të dobët financiar ose mashtrim madje edhe të brendshme, edhe pse zbulimi i mashtrimeve nuk është qëllimi kryesor i një auditimi.

Në një ndërmarrje auditimi i brendshëm ndihmon drejtorët duke vlerësuar fushat kryesore të rrezikut nga mashtrimi, vlerësimin e mjaftueshmërisë së sistemeve të kontrollit dhe duke ndihmuar në zhvillimin e kontrolleve. Pra auditimi është një aktivitet i pavarur dhe objektiv për vlerësimin e informacionit po ashtu për të verifikuar saktësinë e tyre si dhe duke i dhënë këshilla menaxhimit për të kontribuar në përmirësimin e punës së subjekteve.

6. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Auditimi është proces i sistematizuar i mbledhjes dhe krijimit të argumenteve mbi veprimtarinë ekonomike dhe rezultatit me qëllim që të konstatohet baraspesha në mes të raporteve të afarizmit dhe kriterëve të parashtruara dhe kjo t'iu dërgohet shfrytëzuesve të interesuar. Auditimi i ndihmon një organizatë të arrijë objektivat e vëna duke ndjekur në mënyrë të vazhdueshme zbatimin e legjislacionit, duke e vlerësuar aktivitetin dhe synuar përmirësimin e tij, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe të menaxhimit të rreziqeve.

Auditimi i brendshëm është projektuar për të shtuar vlerën dhe për të përmirësuar operacionet e organizatës. Kjo ndihmon organizatën në përmbushjen e objektivave të saj duke sjellë një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e menaxhimit të riskut, kontrollit dhe proceseve. Auditimi i brendshëm është një funksion i themeluar nga menaxhmenti për të ndihmuar në qeverisjen e korporatave duke vlerësuar kontrollet e brendshme dhe duke ndihmuar në menaxhimin e riskut.

Punët më të rëndësishme që i kryen auditori i brendshëm në kuadër të ndërmarrjes janë: hetimi i funksionimit të sistemit kontabël, hetimi i të dhënave të tjera dhe kontabël, hetimi i efikasitetit, ekonomitetit dhe efektivitetit në funksionimin e ndërmarrjes, vlerësimi i riskut, rrjedha e proceseve dhe dokumentimi i tyre, vlerësimi i kontrollit, testimi dhe raportimi.

Procesi i auditimit kalon nëpër disa faza për t'u përfunduar: njoftimi, planifikimi, mbledhja e hapjes, puna në terren, komunikimi, hartimi i raportit, përgjigjia apo reagimi i menaxhmentit, mbledhja mbyllëse, krijimi i raportit final dhe distribuimi i tij dhe rishikimi.

Një auditim i brendshëm është projektuar për të shqyrtuar se çfarë një kompani është duke bërë për të identifikuar kërcënimet e mundshme për shëndetin dhe të përfitimit të organizatës, dhe të bëjë sugjerime për zbutjen e rrezikut të lidhur me këto kërcënime, në mënyrë që të minimizojnë kostot.

7. REFERENCAT

ACCA. (2011) *BPP Learning Media Ltd, Audit and Assurance*. Fq. 38 – 65. UK.

Institute of Internal Auditor. (2006) *The role of Auditing in Public Sector Governance*. Florida, USA.

International Professional Practices Framework (IPPF) (2011) *The Institute of Internal Auditors Research Foundation*. Florida, USA.

Jakupi, Sh. & Krasniqi, F. (2012) *Auditim*. Fq. 61-63. Prishtinë.

Lee, T. H. dhe Azham, M. (2008) *An analysis of the historical development and the evolution of auditing*. Journal of Modern Accounting and Auditing.

Mautz, R. K. (1964) *Fundamentals of Auditing*. 2nd Ed. New York: John Wiley & Sons, Inc.

Ministria e Financave. (2011) *Doracaku i Auditimit të Brendshëm - Pjesa I; Menaxhimi i aktiviteteve të Auditimit të Brendshëm*. Prishtinë, Kosovë.

Ministria e Financave. (2011) *Doracaku i Auditimit të Brendshëm - Pjesa II: Procesi i auditimit*. Prishtinë, Kosovë.

Ministria e Financave të Shqipërisë. (2010) *Manuali i Auditimit të Brendshëm*. Fq. 15. Shqipëri.

Montgomery, R. H. (1949) *The American Economic Review*. Published by: American Economic Association [Online] Qasshëm nga:

https://www.jstor.org/stable/1827981?seq=1#page_scan_tab_contents

Ramamoorti, S. (2003) *Internal auditing: History, evolution, and prospects*. [Online] <https://na.theiia.org/iia/f/Public%20Documents/Chapter%201%20Internal%20Auditing%20History%20Evolution%20and%20Prospects.pdf>

Sawyer, L. B. (1993) *Internal Auditor, Institute of Internal Auditors*. Altamonte Springs. FL: Institute of Internal Auditors.

Sawyer, L.B. & Dittenhofer, M. A. (1981) *The Practice of Modern Internal Auditing*. 4th edition. Altamonte Springs. FL: Institute of Internal Auditors.

The Center of Excellence in Finance. (2010) *Bazat e auditimit të brendshëm*. Ljubljana, Slovenia.

Porter, B., Simon, J., dhe Hatherly, D. (2005) *Principles of External Auditing*. Edicioni i 4-të. USA: Wiley Publication.

8. APPENDIXES

Pyetësor:

Ky pyetësor ka për qëllim mbledhjen e informatave në lidhje me benefitet që auditimi i brendshëm i sjell kompanive në Kosovë. Përgjigjet tuaja më këtë pyetësorë do të mbesin anonime dhe nuk do të shfrytëzohen për qëllime tjera.

Emri i kompanisë

1. Sa keni përfitime nga auditimi i brendshëm në kompaninë ku punoni?

Fare

Mesatarisht

Shumë

2. A ndikohen bashkëpunëtorët nga raportet e auditimit?

Fare

Mjaftueshëm

Shumë

3. Auditimi i brendshëm, si faktor për zhvillim të biznesit?

Pengesë

Nxitës

Tjetër:

4. Auditimin në kompaninë tuaj e bëni në mënyrë:

Vullnetare

Sepse jeni obligues ligjor

5. Cilat nga benefitet e mëposhtme i keni nga auditimi i brendshëm në kompaninë tuaj?

Identifikimi dhe vlerësimi i rreziqeve

Transparenca

Besueshmëria

Rritjen e marrëdhënieve me palë të interesit

Menaxhimin e riskut

Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të proceseve

Përmendni edhe disa përfitime të tjera:

-
-
-
-

6. Sa i besoni raporteve të auditimit të brendshëm?

Fare

Mesatarisht

Shumë

7. A duhet të auditohen të gjitha bizneset pavarësisht veprimtarisë dhe madhësisë?

Po

Jo

8. Sa ndikon auditimi i brendshëm në menaxhmentin e biznesit?

Fare

Mesatarisht

Shumë

Shpjegoni arsyet e përgjigjes tuaj:

Ju lutemi dhe një herë të kontrolloni në qoftë se u jeni përgjigjur të gjitha pyetjeve,
Faleminderit për kohën tuaj.